



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija General Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr. 102/2019  
Data: 10.05.2019

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit me Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazet Zyrtare Nr.7),(01 Mars 2019), nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores Nr. 02/2011, (22.03.2011), për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive , si dhe Rregulloren e MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nxjerr:

**V E N D I M**

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme për mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor.

**I**

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i MMPH-së, kodi ekonomik 50100 në vlerë 200,000,00€.

**II**

1. Mjetet e përmendura në nenin I. do të shpërndahen në bazë të ftesës publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**III**

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike
  2. Udhëzuesi për aplikim
  3. Formularët e aplikimit
  4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
  5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
- Formulari i Aplikacionit për Projekt/ programit (*e detyrueshme*)-(Formulari 9)
  - Formulari i Buxhetit (*e detyrueshme*)-(Formulari 10)
  - Formulari i deklaratës për të financimit të dyfishtë (*e detyrueshme*)-(Formulari 11)
  - Formulari i deklaratës se partneritetit (*nëse aplikohet*)-(Formulari 12)
  - Formulari i deklaratës se projekteve të financuara (*e detyrueshme*)-(Formulari 13)
  - Deklaratë pranimit për kryerjen e aktiviteteve në projekt (*e detyrueshme*)-(Formulari 14)
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
  2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
  3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

#### IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare ([www.mmph-rks.org](http://www.mmph-rks.org)).

#### V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

#### VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është njësia/Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave si dhe Divizioni për Komunikim me Publikun.

IX.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Arben Çitaku

Sekretar i Përgjithshëm

